La tv parla la nostra lingua, grazie al *format* televisivo "ArberiaTVOccitana", che va in onda ogni martedì alle ore 20:00 su Ten - Teleuropa Network. Il progetto, ideato da Alfredo Frega (fino a poco tempo fa Direttore esecutivo) e da Nicola Bavasso (prima responsabile della programmazione ed ora Direttore del *format*), presentato a Cosenza presso il Palazzo della Provincia il 5 maggio 2008 e finanziato dalla Presidenza dei Ministri in base alla legge 482/99, è un notiziario bilingue delle comunità arbëreshe ed occitane della Calabria. Viene trasmesso dal 6 maggio 2008 da Ten - Teleuropa Network, in collaborazione con l'Amministrazione Provinciale di Cosenza - Assessorato alle Minoranze Linguistiche e l'Università della Calabria - Dipartimento di Linguistica - Sezione Albanologia, inizialmente in 3 giorni settimanali (martedì, mercoledì e giovedì) con una durata di 35 minuti per 44 numeri complessivi. Ora il *format* ha una durata di circa 30 minuti e va in onda il martedì alle 20:00 e in replica il mercoledì alle 12:30, con la diretta ogni 2 settimane per 25 numeri complessivi, ed è così formato: un Tg (*gazetë*) della durata di circa 8 minuti e uno spazio di approfondimento e cultura (*Rilindja* - Rinascita), della durata di circa 15-20 minuti, in cui trovano spazio vari temi quali storia, lingua, letteratura, rito religioso, tradizioni, socialità e terre di provenienza (Albania), ed è suddiviso in incontri con personaggi e luoghi dell'Arbëria (*takime*) e biografie di uomini illustri del nostro passato (*pasqyre* - specchio).

Il *format* mira a valorizzare il grande patrimonio culturale rappresentato dalle minoranze linguistiche di cui la Provincia di Cosenza si arricchisce, attraverso la presenza di 22 comuni di minoranza arbëreshe ed 1 comune di minoranza occitana. In esso si intravede la possibilità per le comunità di minoranza di riappropriarsi della loro piena identità, rappresentata dall'uso della lingua di origine, dalla cultura e dalle tradizioni, che costituiscono le radici solide su cui meglio costruire il futuro. Il *format*, inoltre, si avvale della collaborazione degli operatori degli sportelli linguistici, per la traduzione dei servizi e la conduzione del Tg in lingua. È possibile vedere tutte le puntate del *format* anche sul sito internet www.tenonline.it/arberia.

SHËN MITËR**Ngjyra e ajërit: E prezentuan filmin me metrazh të shkurtër mbi Azzinari-n**

E prezentuan ditën 13, të shtunë, tek salla e kuvendeve të Kullexhit të Shën Adrianit, Shën Mitër, filmin me metrazh të shkurtër "Azzinari: Il colore del vento", të prodhuar ka shënmitroti Demetrio Loricchio dhe të xhiruar dhe të drejtuar ka regjisorin Alejandro Macchi me origjinë argentinase. Filmi me metrazh të shkurtër u prodhua dhe u relizua me fondet krahinore e parashikuara për pakicat gjuhësore (Ligji Krahinor 15/2003). Tek paraqitja muartin pjesë prodhuesi Demetrio Loricchio, artisti Franco Azzinari dhe Lello Pagliaro, autori i muzikave. Ishin të pranishëm edhe Kryetari i katundit arbëresh, Antonio Sposato, dhe Asesori për Turizmin dhe Pakicat Gjuhësore, Damiano Guagliardi. Tek ndërhyrja e tij Asesori, ndër të tjera, theksoi se "nxitja e këtyre veprave është themelore sepse ato janë shëmbulli dhe hapi i parë i atij projekti turistico kulturor që i kushtohet vlerësimit të pasurive të Kalabrisë, tue u nisur ka burimet bujqësore njera tek ato kulturore për një ide zhvillimi të krahinës që ka t'ia sjellë një shtim turizmit dhe prandaj ekonomisë".

Filmi e bën të qartë dhe e shpjegon veprën e Azzinari-t dhe idenë e tij krijuese t'ia japë ngjyrë ajërit tue e mbërthyer lëvizjen mbi pëlhurën. Ajëri merr jetë dhe ngjyrë tek lëvizja e natyrës, që riprodhohet shpesh mbi pëlhurat e tij. Ishin shumë njerëzit që e mbjuan sallën e kuvendevet, të ardhura ka Shën Mitri dhe ka katundet e tjerë e zonës përreth.

ARBËRI**Televizioni fjet arbërisht**

Televizioni fjet si na, me programin televiziv "ArberiaTVOccitana", që transmetohet çdo të martë në orën 20:00 mbi Ten - Teleuropa Network. Projekti që menduar ka Alfredo Frega (që qe Drejtor ekzekutiv njera pak mot praptë) dhe ka Nicola Bavasso (që qe përgjegjës për planifikimin dhe nani është Drejtor), të paraqitur Kosenxë tek Pëllasi i Provinçës më 5 maj 2008 dhe të financuar ka Presidenca e Ministravet në bazë të ligjit 482/99, dhe është një rubrikë lajmesh dygjuhëshe për katundet arbëreshe dhe oçitane të Kalabrisë. Programi transmetohet që ka dita 6 maj 2008 ka Ten - Teleuropa Network, me bashkëpunimin e Administratës Provinçale së Kosenxës - Asesorati për Pakicat Gjuhësore dhe të Universitetit të Kalabrisë - Departamenti i Gjuhësisë - Seksioni i Albanologjisë, më parë për 3 ditë në javë (të martën, të mërkurën dhe të enjten) me një zgjatje 35 minutash për 44 numra të përgjithshme.

Nani programi zgjat nja 30 minutash dhe transmetohet të martën në orën 20:00 dhe me replikë të mërkurën në orën 12:30, me transmetimin drejtpërdrejt nga 2 javë për 25 numra të përgjithshme, dhe përbëhet kështu: ka një gazetë që zgjat nja 8 minutash dhe ka hapësira kulturore "Rilindja" që zgjat nja 15-20 minutash, ku zhvillohen shumë tema si: historia, gjuha, letërsia, riti fetar, traditat, bashkëjetësia dhe atdheu (Shqipëria), dhe nëndahet në takime me personazhet dhe vendet e Arbërisë dhe biografite e personazhevet të nderuar të së kaluarës sonë, pasqyret.

Programi do t'e vlerësojë pasurinë kulturore të madhe që përfaqësohet ka pakicat gjuhësore e Provinçës së Kosenxës, me pranimin e 22 bashkive të minoritetit arbëresh dhe 1 bashkie të minoritetit oçitan. Tek ai shihet mundësia për komunitetet e pakicës t'e marrin përsëri identitetin e tyre, me gjuhën e vet, me kulturën dhe traditat, që janë rrënjat e forta ku është më mirë të themelojmë të ardhmjen. Programi, pra, përfiton ka bashkëpunimi i operatorëve të sporteve gjuhësore, për përkthimin e shërbimevet dhe paraqitjen e telegazetës në gjuhën e pakicës.

Mund të shihen gjithë seritë e programit edhe tek siti internet www.tenonline.it/arberia.



SAN COSMO ALBANESE**Il Santuario dei Santi Cosma e Damiano**

Il Santuario dei Santi Cosma e Damiano, è meta di pellegrinaggi provenienti da tutti i paesi arbëreshë e da tutta la provincia. Fu ricostruito negli anni '60, ed è interamente decorato in stile bizantino con mosaici della Bottega d'Arte Mellini di Firenze eseguiti tra il 1970 e il 1974 e affreschi del Pittore cretese Nikos Jannakakis (1974- 1879). Diviso in tre navate, il Presbiterio è transennato con l'Iconostasi in metallo con le immagini a mosaico di Cristo, della Madonna, di San Giovanni Battista e dei SS. Cosma e Damiano. Le sacre Specie sono contenute in una colomba sospesa all'altare. Nel catino dell'abside è raffigurata la Vergine col Bambino, nel muro absidale la Comunione degli Apostoli e, più giù, i SS. Basilio e Giovanni Crisostomo, autori dei testi della Liturgia Bizantina. Nel mosaico dell'arco trionfale troneggia la figura maestosa e severa del Cristo *Pantokrator* (Dominatore Supremo) che regge un libro con l'Alfa e l'Omega, a simboleggiare che egli è il principio e la fine di tutte le cose. Il ciclo pittorico delle tre navate è incentrato sul ruolo delle tre Persone della Trinità nella storia della Salvezza: l'azione del Padre (navata sinistra), del Figlio Redentore (navata centrale) e dello Spirito Santo suscitatore della santità (navata destra). I mosaici della navata centrale raffigurano scene del Nuovo Testamento: la Natività, il Battesimo di Gesù, l'ingresso di Gesù a Gerusalemme, la Crocifissione, la discesa negli Inferi, la Pentecoste. Nella volta è affrescata l'Ascensione. Tanto serena è la scena della natività, con il suo paesaggio agreste popolato di greggi e pastori sovrastati dagli angeli osannanti o nunzianti, quanto drammatica la Crocifissione con le imponenti figure chiuse in un muto dolore. Gli affreschi della volta sinistra rappresentano episodi del vecchio Testamento: la creazione dell'uomo, il peccato originale e la cacciata dal Paradiso terrestre, il sacrificio di Noè dopo il diluvio per ristabilire l'alleanza con Dio, la consegna a Mosè delle tavole della Legge e il rovelto ardente (simbolo della verginità perpetua della Madre di Dio), l'ospitalità offerta da Abramo a tre Angeli in sembianza umana (simbolo della mensa eucaristica e della Trinità), il sacrificio di Isacco (simbolo di Cristo che sacrifica la sua vita per gli uomini), il profeta Elia che riceve il cibo da un corvo, dall'Angelo e dalla vedova di Sarepta, la vittoria del futuro re Davide sul gigante Golia, la visione del profeta Isaia (Dio in trono circondato dai Serafini dalle sei ali), Giona che dopo tre giorni esce dalla bocca del cetaceo (simbolo della risurrezione di Cristo). Nella parete d'ingresso della navata sinistra, è dipinta la parabola delle dieci vergini (un monito per non farsi sorprendere dalla morte). Altre due scene nella parete di fondo: Gesù che cammina sulle acque e le nozze di Cana. Nella volta destra sono affrescate scene della vita dei SS. Cosma e Damiano, espressione della Chiesa che vive e fruttifica grazie all'impulso dello Spirito Santo: i santi istruiti nella dottrina cristiana dalla madre Teodora, la guarigione dell'emorroissa Palladia, le guarigioni dei malati, i santi condannati a morte dal prefetto Lisia, la flagellazione, tre tentativi falliti di esecuzione della condanna (lapidazione, annegamento, fornace ardente) e infine, al centro, la decapitazione. Nella parete d'ingresso è rappresentata la Dormizione (cioè la morte e l'assunzione in cielo) della Vergine, in quella di fondo i SS. Cosma e Damiano affiancati da due angeli. Lungo le pareti delle navate laterali sono affrescate figure di santi.

**STRIGAR****Shënjtërorja e Shënjtravet Kozmai dhe Damiani**

Tek Shënjtërorja e Shënjtravet Kozmai dhe Damiani vërshojnë pelegrinë ka gjithë katundet arbëreshe dhe ka Provinça e tërë.

E rindërtuar në vitet '60, është dekoruar e tërë në stil bizantin me mozaikë të studios arti Mellini të Firences e me afreskë të piktorit kretez Nikos Jannakakis. I ndarë në tri anijata, Prezbiteri është izoluar ka Ikonostasi metali me mozaikë që përfyturojnë Krishtin, Shën Mërinë, Shën Janin Pagëzues dhe Shënjtrat Kozmai dhe Damiani.

Naforat e shënjta ruhen mbrënda një pëllumbi që pezullon mbi autarin. Tek legeni i absidës paraqitet Shën Mëria me të Birin, tek muri i absidës Kungimi i Apostujvet dhe, më poshtë, Shënjtrat Vasili dhe Jani Gojartë, autorë të teksteve të Liturgjisë bizantine. Tek mozaiku i harkut triumfal mbizotëron fytyra madhështore e Krishtit Pantokrator (Mbizotëruesi) që mban një libër me letrat Alfa dhe Omega, që simbolizojnë se ai është nisja dhe fundi i të gjithave. Cikli piktorik i të trija anijatave e vë në qendër rolin e të trija vetave të Trinisë tek historia e Shpëtimit: veprimi i Atit (tek anijata e majtë), i të Birit Shpërblimtar (tek anijata qendrore) dhe i Shpirtit të Shënjtë që ngjall shenjtërinë (tek anijata e djathtë). Mozaikët e anijatës qendrore paraqitin skena të Dhjatës së re: Lindjen e Krishtit, Pagëzimin, hyrjen në Jerusalem, Kryqëzimin, zbritjen në Skëterrën, Rrëshajën. Tek qemeri është afreskuar Ngjitja e Krishtit në qiell. Aq e shtruar është skena e lindjes, me peisazhin e saj fshatar të populluar me grigja dhe barinj dhe, lart, me engjëj që himnojnë apo lajmërojnë, sa dramatik është Kryqëzimi me ato figura madhështore të mbullitura tek një pikëllim të pajalë. Afresket e qemerit të majtë paraqitin episode të Dhjatës së vjetër: krijimin e njeriut, mëkatën e parë dhe dëbimin ka Parrajsi i tokës, flijimin e Noeut pas përmytjes sa të ripërfundoni besëlidhjen me Tynzotin, dorëzimin Moisiut e dërrasavet të Ligjit dhe ferrin e ndezur (simbol i virgjërisë së përhershme të Shën Mërisë), mirëpritjen e Abramit ndaj tri Engjëjvet me fytyrë njerëzore (simbol i tryezës eukaristike dhe të Trinisë), flijimin e Izakut (simbol i Krishtit që flijohet për njerëzit), profetin Eli që merr të ngrënë ka një korb, ka një Engjëll dhe ka vejusha e Sareptës, fitoren e Mbretit të ardhshëm David mbi gjigantin Golia, vegimin e profetit Isai (Ynzoti në fron i rrethuar ka Serafinët, me gjashtë penda), Jonën që pas tri ditësh del ka goja e cetaceut (simbol i Ngjalljes së Krishtit). Tek muri i hyrjes së anijatës së majtë është pikturuar shëmbëlltyra e dhjetë Virgjëreshave (një thirrje sa të përgatitesh për vdekjen). Dy skena tjetra tek muri i fundit: Zoti Krisht që ecën mbi ujërat dhe dasma e Kanës. Në qemerin e djathtë janë afreskuar skena ka jeta e shënjtravet Kozmai dhe Damiani, shprehje e qishës që jeton dhe sjell fryt për ndjetë Shpirtit të Shënjtë: mëma Teodora që ua mëson Shënjtravet dijen e krështerë, shërimi i emorroisës Palladje, shërimi i të sëmurëvet, Shenjtrat të dënuar me vdekje ka prefekti Lisje, fshkullimi, tri përpjekje ekzekutimi të dështuara (gurëdhedhja, mbytyja, furra e ndezur), dhe në fund, te qendra, kryepërja. Tek muri i hyrjes së anijatës së djathtë është paraqitur Fjetja (domethënë vdekja dhe Ngjitja në qiell) e Shën Mërisë, tek ai i fundit Shenjtrat Kozmai dhe Damiani me dy engjëj afër. Tek muret e anijatave anësore janë afreskuar figura shënjtërash.



Cultura italo-albanese e tradizione popolare / *Kultura arbëreshe dhe tradita popullore* Canti per la Settimana Santa / *Kangjelet e Javës së Madhe*

Il primo canto che segue si canta la sera del Giovedì Santo nella comunità di S. Demetrio C. e rappresenta uno dei momenti più toccanti della Settimana Santa: dopo la lettura del Quinto dei dodici Vangeli, si spengono le luci e le donne intonano il canto mentre il papà porta in processione la croce sulle spalle.

Kangjela e parë që pason këndohet mbrëmënet e të Enjtes së Madhe te komuniteti i Shën Mitrit dhe përfaqëson një ka momentet më të ndier të Javës së Madhe: pas leximit të së Pestit të dymbëdhjetë Vangjelevet, shuhen dritat dhe gratë ia marrin këngës ndërsa zoti e sjell në përsjone kryqin mbi mushkun.

E KEQA PENË

(S. Demetrio C. / *Shën Mitër*)

E keqa penë që kur të vrarë
Birin hadhjar ndër duart e pat'.
Ahina qajti sa gurët ndajti
me kët'vaj që bën pjetat.
Mjera u! Bir, si të shënuan,
si të fërruan, oj bir kështu?
Aq të qagartin, të vuçarjartin
sa s'mund të njoh, e nëmura u!
Thuajmë, Bir, kush të dhifisi
kush të përmysi kryet kështu?
Kush të pështiti e kush të nxiti
faqen e bukur? E djegura u!
U që të bëra e mua s'më fjet?
Po rri qet, jot'ëmë jam u!
Foli sat'ëmi, thuaji: "Mëm!"
Ah! Vdiqe ndutu, e djegura u!
I bukur diell, s'the një fjalë,
ah! Pjesët e tua dua t'i bënj u.
Qen judhe u që ju bëra
e vëra vëra m'e bëtë kështu?
Ah! Qendra pa lipisi
ju mua më vratë si dishtit ju.
Thuajm ti, kurorë, ti si e shpove?
Ti si arrëvove njera ndër tru?
Këto këmbë e duar kush i ka shpuar
gozhda mixore ju qetë ju.
E kam me ty, llanxh farmëkore
gjakun ja nxore tek ja dhe u.
Zëmren time, ti thika ime
ti si s'më theren puru kështu.
Ma u ku vajta? Jeta m'u err
jam si e bjerrë, më kë fjas u?
Oj ky dhullur shpon edhe gurë
më s'mënd rronj, e djegura u.
Oj Patërtern u s'bëra gjë
via jo më të rronj kështu.
Zëmer e Bir, ndë më do mirë,
bën dhe mua të vdes kështu.
Ti Madallenë m'e sepellir'
oj t'im Bir mua këtu.
Po sa lotë ti shprishe sot
Bashkë me mua e djegura u!
Gjirit'e mia ecni ku doni
por mua thoni se vdes këtu.
Pa t'im Bir u të partirënj
jo, s'mënd jetë, e nëmura u.
Ma kumbanjia pa hir ja nxuar
Birin ndër duar mos vdisë ajo.

Zepa e Kodemi Krishtin vjuan
e varrëzuan ndër varr të ri.
Atje ti zëmren vjove të nëmurën
Pëstaj u nise oj Shën Mëri.
Zëmra ju mbyll e qajti gjak
sëmbre me gjak e me hidhi.
Sa shërtoi e sa vajtoi
oj Shën Jani ti vet e di.
Ju që kët'Zonjë e doni mirë
ndih-je t'e qanj ca mot.
Via dhe na qami dica
Birin e saj e vunë ndër botë.
Qani e vajtoni sa të mirë e doni
Pasjonën thoni, qani një herë.
Jo për vandim ma për vajtim
bëni t'e zëni kët'kalimerë.

PASJONA E ZOTIT KRISHT

(S. Sofia d'E., S. Giorgio A., Vaccarizzo A.,
S. Cosmo A., / *Shën Sofi, Mbuat, Vakaric,
Strigar*)

Kultonjëm sa për ne Krishti duroi
e sa jëma për 'të dhullure shkoi.
Sot që jan' dhulluret e Shën Mëris'
mir' i vesh' ju, zonjat e shtëpis'.
Pasjona e Zotit Krisht i qe një shpat'
që zëmërën ja shpoi të pamëkat'.
Krishtin Judha e puthi e e tradhirti,
armiqt' tek bën' racjona ja ngjudhirti.
U sul' si qen' Judhetë, Krishtin e zunë
e lidh' me një tërkuz', mbë truall e shtunë.
Për leshi pa pjetat e shtrashinar',
e shanjin llatër i lik edhe magar'.
Krishti si qëngj' i but' thoj me zëmër:
"Oj Tat ndër qiell, ndëlej këta të nëmur".
Krishtin të parën e qelltin tek Ana,
atje përpara ju djasas kundana.
Mallku tëholq e i ra një grën shkafet'
sa qajti Parrajsi me vërtet'.
Krishtin pëstaj e qelltin te Kajfasi:
majdhe, për straxje ju shkurtua pasi.
Martërit' atje muar' besën rerë
e gjithë than': "Pillat ka t' e vjerrë".
Ish tardu, më shum' se mjeznat':
Krishtin e vun' e ndenj karçirat.
Shën Pjetri at' natë Krishtin negoi,
ma qajti mbjatu që gjeli këndoi.
Judha u vuar, ashtu e meritarti:
Dhimoni ç'e tandoi më e fukarti.
Menatet, porsa u di e Premtja e Madhe,
te Pillati e suall' me thirr'm të madhe.
Thërrisjin: "Ky magar ka të jetë vjerr",
se gjith' katundit i suall dhisturb' e guerr' ".
Pillati e njohu se ish nuxend,
tha: "Jo, të vras këtë u së jam kutjend.
Shih' i që për të të thet' Erodhi,
rregji i tij që sot xhustu më ndodhi".
Erodhi pa se Krishti rrij qet,
"Ky është i llavur" – tha – "e mua s' më fjet".
E veshi ndër të bardha si nuxend,
tha: "Çë të bënj' Pillati u jam kutjend".
Pillati lajti duart, tha: "Nëng e ngas",
thirri: "Ky ë' një shëjt e s' und e vras".
Pëstaj u trëmb e, se të ju jip gust,
"Mirr-je" – tha – "e jipni një frust".

Ndë je kullon' e rrah', e vrushkulloi
gjaku i Zotit Krisht si uj' kroj.
Bëri një det me gjak', e lipisi
jëma pat për të, më mosnjeri.
S'u fryti me këta gjak qent' mixorë,
i pjekstin me ca gjëmbe një kurorë.
Ndë kryet ja ngul' fort e me një hu:
i shpoi ashtin e syut, hyri ndër tru.
Jëma për skundrel' thoj: "Bir,
ti që bëre e shkon gjith këta martir'?"
Ëngjëlit tue qar' thoshjin me lot':
"O, sa mirë do njerëzit yn' Zot!"
Pillati kur e pa me atë kurorë,
me një mandjel të kuq e kallm' mbë dorë,
"Ecce homo" – jasht' ju a buftoi:
"Shih-je si e bëtë ju, më që dojt?"
Thirri qenëria: "E duam mbë kryqt
se të saxjaren ndutu gjithë armiqt' ".
Pillati u trëmb e tha: "Ecni me nëmat,
bën-je si t' e do'i, ju vraçin gjëmat!".
Kërcyen si ulq Judhet' edhe m' u ndënd',
i vunë kryqin ngrah, një trav' të rënd'.
Vej Krishti me kryqt tue rëkuar,
Judhet' me shqelbe e hunj tue mallkuar.
Te Kallvari pak të gjall' e suall',
i vun' gozhda ndër këmb' edhe ndër duar.
E ngrëjtin lart e Zonja e Shën Mëri,
tek pa të bir', atje i ra zali.
Tri or' Krishti rooi mbë kryqt,
vdiq pëstaj e më ndëleu armiqt' .
Dielli e hëna u nxi'n, dheu gjëmoi,
gurët u thyen te' Krishti perëndoi.
Vate një guerc e zëmërën i shpoi,
ma gjaku i Zotit Krisht e dritësoi.
Zepa e Kodhemi ka kryqi e nxuar',
të vdekur s' ëmës ja vunë ndër duar.
Të bir' të vrarë ndër gjunj jëma e mbaj',
me lot' e me hjidhi thoj këtë vaj:
"Bir, si të vranith?
Mua ku më lënit?
Si s' të pa'n' lipisi?
Si s' të ndhihu mosnjeri?
Bir, si të shënuanith!
Bir, si të fërruanith!
Ku të vate ajo bellie'
çë më jip aq llogric'?"
Ruaj si të nxitin,
shih si të pështitin.
Si të bënë, bir, o,
gjithë qag', mjera u, o!
Ka t' erdh kjo kurorë,
kush' t' e theri atë dorë?
Këto këmb' të ngryqësua
cila gozhdë t' i la të shpuara?
Edhe zëmërën t' e shpuan,
me një llënxë t' e zbuluan!
Oj bir, e sa pen'!
Mirrëm mua me vetghen'.
Pa bir, u si të rronj,
këtë thikë si t' e duronj?
Me ty, bir, dua të shihem,
ndë këtë varr dua të mbëllihem".
Ngrëh' i gjithë me lot' e me hjidhi,
bëni kësaj Rrexhin' kumbanji.
Gjithë të mirat ndër Pashk' ajo shtoftë,
ju dhëft' edhe Parrajsin. Ashtu qoftë.

SAN GIORGIO ALBANESE

Festeggiato nonno centenario. Sfatata una leggenda secondo la quale nessuno sarebbe arrivato a compiere 100 anni

Domenico Manfredi ha compiuto, giovedì 25 febbraio, 100 anni e ha festeggiato insieme al figlio, alla nuora e ai nipoti, il suo compleanno a San Giorgio Albanese, paese in cui si è trasferito dall'età di sette anni. Ai festeggiamenti hanno preso parte, oltre ai numerosi concittadini, il parroco di San Giorgio, Vittorio Scirchio, il sindaco, Mario Scura e tutta la giunta comunale. Domenico Manfredi è nato ad Acri il 25 febbraio 1910, ha partecipato alla seconda guerra mondiale e nel 1939 è sbarcato in Libia a Tripoli. È stata sfatata quindi la leggenda di una maledizione secondo la quale nel paese arbëresh mai nessuno sarebbe arrivato a compiere 100 anni, anche se alcuni sostengono che la famiglia Manfredi non sarebbe originaria di San Giorgio e che quindi la maledizione non si sarebbe interrotta. La maledizione fu lanciata dalla famiglia soprannominata dei "Pettinari" che nel 1848 giunsero a San Giorgio e, scambiati per "fattucchieri", furono arsi vivi. Questi maledirono il paese e secondo la maledizione nessuno sarebbe arrivato fino a cento anni.

MBUZAT

I festuar tatëmadhi njëqindvjeçar. U nxuar boja legjendës që thoi se mosnjëri kish të bëhej njëqind vjetësh

Domenico Manfredi bëri, të enjten 25 shkurt, 100 vjet dhe festoj me të birin, të renë dhe nipërit, ditëlindjen e tij Mbuzat, ku u transferua kur ai ish shtatë vjet. Tek festa ishin, përveç shumë bashkëqytetarësh, zoti i Mbuzatit, Vittorio Scirchio, Kryetari, Mario Scura dhe gjithë xhunta bashkiake. Domenico Manfredi u le Aker më 25 shkurt 1910, muari pjesë tek e dyta luftë botërore dhe tek viti 1939 zbarkoi Libi në Tripoli.



Kështu u nxuar boja legjendës së një mallkimi se te katundi arbëresh mosnjëri kish të bëhej njëqind vjetësh, edhe se për disa mallkimi nuk u pre sepse familja e Manfredëve nënë është ka Mbuzati. Nëmi që vënë ka fëmijë e mbiquajtur "Pettinari" që te viti 1848 erdhën Mbuzat dhe, të marrë për "magarë", u dogjtin të gjallë. Këta mallkuan katundin kështu që mosnjëri kish të bëhej njëqind vjetësh.

ARBERIA

Pasqua nei paesi arbëreshë

Si celebrerà ancora con il rito greco-bizantino la Pasqua nei paesi arbëreshë dell'Unione Arberia: una Festa intensamente vissuta e ricca di tradizioni. In questo periodo verranno celebrate le suggestive manifestazioni della Grande e Santa Settimana che rievocano i misteri della Passione, Morte e Risurrezione di Gesù: il 2 aprile, Venerdì Santo, giorno di lutto per la morte di Gesù e il 3 aprile Sabato, giorno in cui si annuncia la Resurrezione di Cristo. A San Demetrio Corone, Vaccarizzo Albanese, San Cosmo e San Giorgio, la notte di sabato i fedeli perpetueranno l'antico rito della "acqua muta" e prima della mezzanotte, si recheranno in silenzio presso una fontana fuori del centro abitato; giunti lì, dopo aver sorseggiato l'acqua, ritorneranno in paese tra gli echi del "Christòs Anësti" (Cristo è risorto), giungendo al tradizionale falò di Pasqua, la "Qerradonulla", simbolo di purificazione. L'ultimo appuntamento con le cerimonie religiose della Pasqua arbëreshe si svolgerà a mezzanotte e in alcuni paesi dell'Unione poco prima dell'alba con la "Fjala e mirë", (la Buona Parola), che evoca l'entrata di Gesù negli inferi, la sua Resurrezione e la riconquista del Paradiso.

ARBËRI

Pashkët te katundet arbëreshe

Ka të festohen akoma me ritin greko-bizantin Pashkët te katundet arbëreshe të Lidhjes Arbëria: një Festë shumë e ndër dhe pjot me tradita. Te kjo periudhë kanë të celebren shfaqjet sugjestive e Javës së Madhe dhe të Shënjtë, që i kujtojnë misteret e Pasjonës, e Vdekjes dhe të Ringjalljes së Zotit Krisht: më 2 prill, tek e Premtja e Madhe, ditë lipi për vdekjen e Krishtit, dhe më 3 prill, të Shtunë, ditë që e njofton Ringjalljen e Krishtit. Shën Mitër, Vakaric, Strigar dhe Mbuzat, natën e së shtunës të krishterët kanë t'e bëjnë të pavdekshëm ritin e vjetër të vjedhet ujët dhe, parë mesnatës, kanë të venë në qetësi tek një krua jashtë ka qendra e banuar; kur arrëvojnë atje, pasi e kanë pirë pak ujë, kanë të mbjidhen në katund tue kënduar "Christòs Anësti" (Krishti u ngjall), tue arritur tek fringullera tradicionale e Pashkëve, "Qerradonulla", simbol pastrimi. Takimi i fundit me ceremonitë fetare e Pashkëve arbëreshe ka të mbahet mesnatë, dhe tek disa katunde e Lidhjes pak mot parë haraksisë, me "Fjalën e mirë", që e rikujton hyrjen e Zotit Krisht te skëterra, Ringjalljen e tij dhe rifitim e Parrajsit.

SAN DEMETRIO CORONE

Corrida 2010: la vittoria va alle scuole Medie

Si è svolta sabato 13 marzo, presso la Palestra comunale, la Corrida 2010, organizzata dai ragazzi dell'ultimo anno del Liceo Ginnasio. Dodici le esibizioni, di canto e danza, eseguite con successo dagli alunni frequentanti l'Istituto Omnicomprensivo ed apprezzate dal folto pubblico e dalla giuria. Sono risultati vincitori: al primo posto il gruppo di danza, formato dalle alunne di terza media Cristina Paloli, Elisabetta Lavorato, Alessandra Loricchio, Barbara Bellucci ed Eugenia Meringolo, che hanno ballato sulle note di "Tik tok"; secondo posto per il maturando Roberto Sposato che ha cantato "Paparazzi", con la coreografia eseguita da Morena Bifano e Tiziana Conte; terzo premio per la coppia formata da Elisabetta Carolei e Francesco Azzinnari, che hanno eseguito il valzer viennese. Alla manifestazione era presente anche il consigliere comunale con delega allo Sport e Politiche giovanili D. Cadicamo.

SHËN MITËR

Korrida 2010: fitorja i vete shkollës së mesme

U mba ditën 13 mars, të shtunë, tek Palestra bashkiake, Korrida 2010, e organizuar ka studentët e vitit të fundit të Liçeut Gjinnas. Dymbëdhjetë qenë shfaqjet, këngësh dhe vallesh, të realizuara me sukses ka nxënësit që ndjekin Institutin Omnipërfshirës dhe të çmuara ka publiku i madh dhe ka juria. Kanë dalë fitues: tek vendi i parë grupi vallëzimi, i formuar ka nxënësit e klasës së tretë të skollës së mesme Cristina Paloli, Elisabetta Lavorato, Alessandra Loricchio, Barbara Bellucci dhe Eugenia Meringolo, që kërcenë mbi notat e këngës "Tik tok"; vend i dytë për studentin e vitit të fundit Roberto Sposato që këndoi "Paparazzi", me koreografinë e luajtur ka Morena Bifano dhe Tiziana Conte; çmim i tretë për palën e formuar ka Elisabetta Carolei dhe Francesco Azzinnari, që luajtin vals in vjenëz. Tek shfaqja ish i pranishëm edhe këshilltari bashkiak i ngarkuar për Sportin dhe Politikat rinore D. Cadicamo.

EDITORE / BOTUES: Unione "Arberia" / Lidhja Arbëria

Sportello linguistico (L. 482/99 annualità 2007) / Sporteli gjuhësor (L.482/99 viti 2007)

Sede / Seli: San Demetrio Corone / Shën Mitër

DIRETTORE RESPONSABILE / DREJTOR I PËRGJITHSHËM: Giovanni Luca Baffa

REDAZIONE / REDAKSIA

Adriana Ponte, Aurora Stracan, Silvia Tocci, Annunziata Bua, Daniela Zanfini